**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI BASHKIAK**
**GRAMSH**

Nr.302/2 Prot Gramsh më 05/02/2021

**VENDIM**
**Nr 05 Date 28/01/2021**

**MBI**

**KRITERET E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6%.**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 29/01/ 2021, pasi mori ne shqyrtim Relacionin e Drejtorise se Zhvillimit dhe Manaxhimit Financiar ,Sektori Mbrojtjes Sociale " Kriteret e perdorimit te fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike deri ne 6%" mbeshtetur ne Ligjin Nr 57 dt 18.07.2019 "Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise,Neni 21*;VKM Nr.597 date 04.09.2019 si dhe ne* Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"neni 8,pika 2;neni 9 ,pika 1.1/a dhe 1.1/b si dhe neni 54 pika ( k) dhe (n);

**VENDOSI:**

1. Te miratojë kriteret mbi përdorimin të fondit te kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në6% si me poshte:

- Te jene familje me kryefamiljare gra.
-Te jene familje ne gjendje te dobet ekonomike.
-Te jene familje me shume anëtare .
-Te jene familje me femijë jetim ne kujdestari .
-Te jene familje me probleme sociale.

2. Per familjet qe do te trajtohen me ndihme ekonomike duhet te jete kryer paraprakisht vlersimi social ekonomik ne familje nga administratori shoqeror sipas formularit tip te verifikimit dhe qe ruhet ne dosjen e dekumentave te aplikantit prane njesise vendore.

3. -Nuk mund te perfitojne ne baze te Vendimit 597 date 04.09.2019, familjet te cilat nuk kane aplikuar per ndihme ekonomike nepermjet Regjistrit Elektronik Kombetar, familjet qe trajtohen me ndihme ekonomike , si dhe familjet qe jane perjashtuar nga sistemi per deklarime te rreme.

4-Per Zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori I Mireqenies Dhe Kujdesit Social,Bashkia Gramsh.
Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes

**Sekretari Keshillit**
**Xhulia Gjini**

**Kryetari Keshillit**
**Greta Lena**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GRAMSH

Konc .Xh. Gjini
Konfirmoi:
Miratoi:G. Lena
Dosja _______
Afati _______